

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi kryetar, Gani Zabeli dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.S. nga Prishtina, për shkak të dy veprave penale vjedhja, parashikuar me nenin 325 par. 1 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, P.nr.907/2016, datë 27.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK-së me 28.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, P.nr.907/2016, datë 27.11.2016, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, me aktgjykimin P.nr.409/2016, datë 27.11.2016, të akuzuarin H.S. e ka shpall fajtor për shkak të 2 (dy) veprave penale të vjedhjes, të parashikuara me nenin 325 par. 1 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK), ku për së cilën vepër e ka gjykuar veç e veç dhe konform nenit 80 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK) i ka shqiptuar dënim unik me burg efektiv në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilën e ka obliguar ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën do të zëvendësohet me dënim me burg prej 10 (dhjetë) ditësh, ashtu që për çdo 20 € të gjobës do t'iu llogaritet një ditë burgim. E ka obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguajnë shumën prej nga 20 €, E dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të pandehurit t'i shqiptoj dënim më të ashpër me burg efektiv.

Në afatin ligjor përgjigje në ankesë, në ankesën e prokurorit të shtetit ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit H.S. av. N.H. me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet kurse ankesa e prokurorit të refuzohet si e pa bazuar

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.69/2017, datë 19.01.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ndaj të pandehurit të shqiptoj një dënim me burg efektiv më të ashpër.

Gjykata e Apelit konform dispozitave të nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën me kohë dhe në mënyrë të rregullt i njoftoj prokurorin e apelit, të dëmtuarat, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, në seancë prezantoi vetëm e dëmtuara L.M. kurse palët e tjera edhe pse të njoftuar në kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë. E dëmtuara L.M. deklaroi se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se parashtron kërkesë pasurore juridike.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPP-së dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithë atë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të pandehurve.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase as në ankesë nuk ka mundur të kontestohet sepse të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj, sipas nenit 383 par. 2 të KPP-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim prokurorit i prokurorisë themelore në Prizren pretendon se dënimi i shqiptuar i të akuzuarit është jo proporcional dhe nuk i përgjigjet peshës së veprave

penale të kryera, natyrës the rrethane ne të cilën janë kryer veprat penale, i pandehuri është recidivist ngase sipas raportit të policisë theksohet se në data bazën e tyre i pandehuri i ka 66 raste të vjedhjes, duke pasur parasysh këtë, dënimi është tejet i butë edhe nuk do të arrihet qëllimi i dënimit

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e prokurorit për një dënim më të ashpër me burg nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, kurse rrethana lehtësues për të akuzuarin ka marrë parasysh qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërësi të veprave të kryera. Pendimin e shfaqur, ka premtuar gjykatës se do ti ndërpres veprimet e kundërligjshme në të ardhmen, se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike ndërsa rrethanë veçanërisht rëndues nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë vlerëson se rrethanat për matjen e dënimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë drejtë janë vlerësuar. Me ankesë prokurori pretendimin se i akuzuari është recidivist nuk e argumenton me asnjë provë, nuk paraqet asnjë rast të aktgjykimit të plotë fuqishëm me të cilin do të argumentonte se i akuzuari është recidivist e që kishte më pasur ndikim në shqiptimin e ndonjë dënimi më të rëndë. Sipas vlerësimit të gjykatës së Apelit dënimi i shqiptuar të akuzuarit në kohëzgjatje prej pesë muajve me burg efektiv si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) euro nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë, dhe se ky dënim do ti shërbej preventives gjeneralë dhe asaj individuale dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të ndikojnë në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 401 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.45/2017, datë 28.03.2017

Bashkëpunëtor profesional,
Hysni Ismaili,

Kryetar i kolegjit
Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit:

Gani Zabeli
Shqipe Qerimi